



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr.62 datë 30.12.2015

Për

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 63, DATË 8.11.2005, “PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT” (i ndryshuar)”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/I shkronja “d”, nenit 10, pika 3/I, shkronja “g” dhe nenit 33 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar); nenit 4, pika 4 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit” (i ndryshuar); nenit 125 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.63, datë 08.11.2005 “Për miratimin e komisionit të strehimit” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Pika 1 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.63, datë 08.11.2005, “Për miratimin e Komisionit të Strehimit” (i ndryshuar), ndryshon si më poshtë:

Komisioni i Strehimit, pranë Bashkisë së Tiranës përbëhet si më poshtë:

- Kryetar Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale;
- Anëtar Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit;
- Anëtar Drejtor i Drejtorisë Juridike;
- Anëtar Drejtor i Drejtorisë së Strehimit Social;
- Anëtar Drejtor i Drejtorisë së Financës;
- Anëtar Përfaqësues nga Instituti i Integritit të Përndjekurve;
- Anëtar Përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë;
- Anëtar Përfaqësues nga Shoqata e Romëve për Integrim dhe Kundër Trafikimit të Fëmijëve.
- Anëtar Përfaqësues nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, (ADRIF)

2. Ngarkohet Komisioni i Strehimit, i cili në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Strehimit Social t'i paraqesin për miratim Kryetarit të Bashkisë rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimit Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI